



Raport i Analizës së Situatës mbi Nevojat për Shërbime Sociale në Bashkinë Dibër 2016

Mirënjohje

Partnerë për Fëmijët ka dëshirë të falenderojë për kontributin dhe punën e tyre anëtarët e Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër, pa të cilët hartimi i këtij raporti mbi situatën e nivelit të ofrimit dhe nevojave për shërbime sociale nuk do të ishte i mundur. Në vazhdim, autori dëshiron të falenderojë Zj Nevila Manga dhe Zj Gonxhe Kandri për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në zhvillimin e përmbajtjes së këtij raporti.

Autore

Ingrid Jones MSc

Nëntor 2016

Përmbajtja

Mirënjohje	2
Hyrje	4
Përcaktimi i Shërbimeve Sociale	5
Zhvillimi i Metodologjisë së Studimit dhe Instrumentave	6
Niveli Aktual i Shërbimeve në Bashkinë Dibër	7
Shërbimet Prioritare të Identifikuara nga Studimi	9
Përfundime	11
Rekomandime	12
Shtojca	14
Referenca	18

Hyrje

"Puna Sociale është një profesion i bazuar mbi praktikën dhe një disiplinë akademike që promovon ndryshimin dhe zhvillimin social, kohezionin social si dhe fuqizimin e njerëzve. Parimet e drejtësisë sociale, të drejtat e njeriut, përgjegjësia kolektive dhe respektimi i dallimeve janë thelbësore në punën sociale. "¹

Ky Raport Analize është produkti i punës së Grupit të Aktivistëve në Bashkinë Dibër pas gjashtë muaj nga krijimi i tyre. Anëtarët e Grupit janë të moshës nga gjashtëmbëdhjetë vjeç deri në moshën dyzetë e pesë vjeç, meshkuj dhe femra të cilët vijnë nga: Dobrova, Maqallara, Muhurri, Peshkopia, Pilafi dhe Tomini. Anëtarët e grupit janë: nëna, baballarë, nxënës, mësues, gra biznesmene, drejtore kopështi, rrobaqepëse, përfaqësues nga shoqëria civile dhe psikologë.

Grupi Aktivistëve është krijuar në Prill të vitit 2016 në kuadër të projektit "Advokaci Komunitare për Shërbime Sociale në Bashkinë Dibër", projekt i cili mbështet nga LëvizAlbania dhe zbatohet nga Partnerë për Fëmijët. Disa nga anëtarët e Grupit të Aktivistëve kanë marrë pjesë në projektet e mëparshme që ka zbatuar Partnerë për Fëmijët në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në Dibër dhe të cilët kanë treguar interes për t'ju bashkuar këtij grupi ndërsa anëtarët e tjerë janë ftuar nëpërmjet kontakteve në komunitet. Të gjithë anëtarët marrin pjesë vullnetarisht në takimet e grupit dhe aktivitetet e projektit.

Parimi i këtij projekti është: "Advokacia është procesi i pjesmarrjes së njerëzve në proceset vendimarrëse që ndikojnë jetët e tyre."¹

Qëllimi i projektit është të: Fuqizimi anëtarëve të komunitetit të Bashkisë Dibër në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale për të rinjtë dhe të rriturit në nevojë.

Objektivat e Projektit

1. Të zhvillojë kapacitetet e grupit komunitar për të advokuar pranë strukturave të pushtetit lokal në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve sociale në Bashkinë Dibër.
2. Të përmirësojë ndarjen dhe shkëmbimin e informacionit midis qytetarëve dhe pushtetit lokal në Bashkinë Dibër duke fuqizuar pjesëmarrjen qytetare dhe vendimmarrjen.

Përcaktimi i Shërbimeve Sociale

Sipas ligjit Shqiptar ka dy lloje të shërbimeve sociale, një është përfitimi monetary dhe forma tjetër janë shërbime që ofrohen në shtëpi, në komunitet, shërbime të specializuara apo në qendra rezidenciale. "*Shërbimet sociale*" përfaqësojnë një sistem të integruar dhe të organizuar të përfitimeve dhe lehtësirave që ofrohen nga profesionistë të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim përmirësimin e kushteve të personave të pafavorizuar".²

¹ Ibid¹

² P R O J E K T L I G J I P Ë R S H Ë R B I M E T E K U J D E S I T S H O Q Ë R O R N Ë R E P U B L I K Ë N E S H Q I P Ë R I S Ë, 3 G U S H T 2 0 1 6

Në kuadër të projektit, koncepti i shërbimeve sociale u përkufizua më gjerësisht duke përfshirë të gjitha format e asistencës, këshillimit, terapisë apo shërbimeve që ofrohen me qëllimin rehabilitimin, Identifikimin, mbështetjen dhe ndihmën për të zhvilluar potencialin e të gjithë fëmijëve dhe/ose të rriturve me aftësi të kufizuara.

Sipas *Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara*, personat me aftësi të kufizuara janë ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore. Kjo vlen veçanërisht nëse fëmijët janë me aftësi të kufizuara ose rrezikojnë të bëhen me aftësi të kufizuara "³.

Aftësia e kufizuar ekziston nëse ky dëmtim çon në një kufizim të pjesëmarrjes që prek një ose disa fusha të jetës. Kërkesa për një kohëzgjatje të mundshme të kufizimit prej gjashtë muajsh përjashton parregullsitë e përkohshme, por jo ndërhyrjet që duhet të ndërmerren sa më shpejt që të jetë e nevojshme në raste individuale. Kjo vlen veçanërisht në rastet kur fëmijët tashmë janë me aftësi të kufizuara ose rrezikojnë të bëhen me aftësi të kufizuara".

Zhvillimi i Metodologjise dhe Instrumentave të Studimit

Në mënyrë që anëtarët e Grupit të Aktivistëve të kuptonin se çfarë shërbimesh sociale ofroheshin për individët, familjet, familjet me fëmijë apo familjeve me anëtare me aftësi të kufizuara, anëtarët e Grupit kanë zhvilluar një pyetësor prej 4 faqesh. Pyetësori ka përfshirë pyetje të cilat fokusohen në llojet e shërbimeve sociale, arsimore dhe të mbështetjes që

³ Strategjia Kombetare per Personat me Aftësi Te Kufizuara

ofrohen aktualisht në Bashkinë Dibër dhe gjithashtu për llojet e shërbimeve apo ndihmës që anëtarët e komunitetit do të donin që të ofroheshin nga qeverisja lokale ku ata jetojnë. Një kopje të pyetësorit mund t'a gjeni në Shtojcën 1.

Pyetësorët janë administruar nga vullnetarët dhe anëtarët e Grupit të Aktivistëve në njësitë vendor në Peshkopi, Kastriot, Maqellarë, Brezhdan, Rrashnapojë dhe Muhurr gjatë periudhës Gusht – Tetor 2016. Në total janë plotësuar 750 pyetësorë.

Tetë anëtarë të Grupit të Aktivistëve kanë bërë hedhjen e të dhënave në një database në për të analizuar të dhënat e mbledhura. Ky Raport Analize është hartuar në bazë të analizës së të dhënave të mbledhura.

Niveli aktual i shërbimeve në Bashkinë Dibër

Të intervistuarit janë pyetur se çfarë shërbimesh ofrohen aktualisht në fshatrat, qytetet apo komunitetet e tyre. Më poshtë është lista e shërbimeve të përmendura:

Tabela 1 Shërbimet që ofrohen aktualisht

Shërbimet	Numri i atyre që janë përgjigjur
Ndihma Ekonomike	364
Pagesa e papunësisë	44
Pagesa e Aftësisë së Kufizuar, (KMCAAP)	76
Pagesa e Kujdestarisë për një fëmijë apo person me aftësi të kufizuara	24
Pension pleqërie	237

Përveç shërbimeve të mësipërme, të intervistuarave i'u është ofruar një listë me shërbime sociale të mundshme për të cilat janë pyetur nëse do të donin që këto shërbime të ofrohen në komunitetin e tyre. Ju lutem referojuni Tabelës 2.

Tabela 2 Shërbimet Sociale që ofrohen ose jo

Llojet e Shërbimeve Sociale	Numri i të intervistuarve të cilët kanë deklaruar shërbimet sociale specifike që janë në dispozicion	
	PO	JO
Kopësht apo çerdhe për fëmijët që nga lindja deri në 7 vjeç	650	85
Grup për nënat e reja	46	638
Klasa prindërore	54	627
Qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara	0	699
Qendër ditore për të rriturit me aftësi të kufizuara	0	666
Qendër ditore për moshën e tretë	116	589
Qendra apo shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara	3	686
Vizita në shtëpi nga stafi i shëndetit parësor	564	138
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve	109	561
Zyra e Familjes/Genderit	82	603
Shërbime për shëndetin mendor	32	659
Bibliotekë për fëmijët	330	370
Kënde lojrash	58	645

Nga përgjigjet e dhëna është e qartë që disa njerëz kanë akses në shërbimet sociale dhe disa të tjerë nuk kanë. Cuditërisht ofrimi i një qendre ditore për fëmijët ose të rriturit me aftësi të kufizuara aktualisht nuk ofrohet si shërbim në Bashkinë Dibër dhe vetëm rreth një e katërta e të anketuarve kanë akses në një qendër ditore për personat e moshuar.

Aktualisht nuk ofrohet asnjë lloj shërbimi rehabilitimi për personat që mund të kenë aftësi të kufizuara. Gjithashtu ka një nevojë shumë të madhe për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet.

Mbrojtja e fëmijëve dhe ofrimi i shërbimeve për të përmbushur nevojat e fëmijëve në rrezik të lëndimit, keqtrajtimit, neglizhencës apo trafikimit ka qenë prioritet i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që nga viti 2010, por më pak se një e pesta e të anketuarve ishte në dijeni të ekzistencës së një njësie për mbrojtjen e fëmijëve në qytetin e Peshkopisë dhe shërbimeve që ajo ofron. Gjithashtu, mungesa e këndeve të lojrave për fëmijët ishte një nga nevojat e identifikuara gjatë studimit.

Shërbimet Prioritare të Identifikuara nga Studimi

75% e të anketuarve kanë deklaruar se shërbimet që mungojnë aktualisht dhe që ata do të donin që të ofroheshin në komunitetin ku jetojnë janë për 1) Fëmijët me aftësi të kufizuara; 2) 60 % e të intervistuarve janë shprehur se për të rriturit me aftësi të kufizuara do të donin të shihnin përmirësime në shërbimet për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara; 3) 40 % e të intervistuarve janë përgjigjur se do të donin të kishin më shumë shërbime sociale.

1. Për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara:

- Një qendër ditore e pajisur me specialist: fizioterapist, logopedist, etj – 63 %
- Paisje si paterica dhe karrige me rrota - 8 %
- Pagesa më të mira të aftësisë së kufizuar - 6 %
- Psikologë - 3 %

2. Për të Rriturit me Aftësi të Kufizuara:

- Qendër Ditore - 80 %
- Pagesë për kujdestarët - 18 %
- Rritje të shumës së ndihmës ekonomike - 2 %

3. Akses në Llojet e mëposhtme të Shërbimeve Sociale:

- Zyrë për Mbrojtjen e Fëmijëve - 32 %
- Shërbime psikologjike - 36 %
- Punonjës Social - 21 %
- Këshillim - 11%

Të intervistuarit gjithashtu përmendën se ata do të donin të kishin më shumë kopshte dhe shkolla dhe/ose përmirësime të gjëndeje së ndërtesave aktuale duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe aksesin dhe mjedisin mësimor.

Nëpërmjet analizimit të të dhënave, katër prioritetet e dala për përmirësime janë:

1. Hapja e një qendre multidisciplinare me specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara - 367 të intervistuar;
2. Përmirësimi i shërbimeve sociale duke përfshirë, vendosjen e mësuesve ndihmës, gjëndjen e shkollave dhe kopshtëve dhe hapja e kopshteve të reja - 164 të intervistuar;
3. Rritja e pagesës mujore të Ndihmës Ekonomike - 117 të intervistuar;
4. Ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë - 111 të intervistuar.

Përfundime:

Nga informacioni i mbledhur gjatë studimit, është e qartë që ka një mungesë shërbimesh apo një nivel shërbimesh të papërshtatshme të shërbimeve sociale të ndryshme të ofruara për fëmijët apo të rriturit në Bashkinë Dibër. Shërbimet që ofrohen aktualisht janë pagesat monetare. Është e qartë se kjo nuk i plotëson kërkesat minimale të përcaktuara nga qeveria "... shërbimet që ofrohen nga profesionistë të entiteteve publike ose jopublike, me qëllim përmirësimin e kushteve të personave të pafavorizuar"¹

Bashkia e Dibrës ende nuk ka një strategji për zhvillimin, ofrimin ose zbatimin e shërbimeve sociale dhe prandaj kjo i lë ato fëmijë dhe / ose të rritur që janë të marginalizuar; me aftësi të kufizuara; të varfër apo të prekshëm, pa shërbime specifike që mund t'i ndihmojnë ata në jetën e tyre të përditshme.

Prioritetet që janë theksuar në këtë Raport Vlerësimi të Situatës, kërkesa për një qendër ditore shume-funksionale për fëmijët me aftësi të kufizuara; përmirësime në barazinë dhe nivelin e ofrimit të arsimit; rritja e pagesës mujore të ndihmës ekonomike si dhe ndërtimi dhe mirëmbajtja e terreneve sportive në të gjithë bashkinë, duhet të planifikohen në mënyrë strategjike dhe të përfshihen brenda buxhetit vjetor nga Bashkia Dibër, qeveria qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në bashki.

Rekomandime:

Në vijim janë rekomandimet që rrjedhin nga vlerësimi i situatës i kryer në kuadër të projektit "Advokaci Komunitare për Shërbime Sociale në Bashkinë Dibër", financuar nga LevizAlbania dhe zbatuar nga Partnerë për Fëmijët.

1. Bashkia e Dibrës dhe Këshilli Bashkiak duhet të shqyrtojnë urgjentisht nevojat e qytetarëve të tyre dhe të planifikojnë, zhvillojnë dhe ofrojnë një gamë të shërbimeve sociale për të përmbushur nevojat e vlerësuara sa më shpejt që të jetë e mundur në përputhje me ligjin.
2. Krahas planifikimit duhet të ketë buxhetim dhe alokim të fondeve vjetore për staf të kualifikuar dhe me përvojë, ambientet, pajisjet, resurset, gamën e shërbimeve cilësore sociale dhe transport.
3. Bashkia Dibër duhet të adresojë menjëherë mungesën e një qendre shumë-funksionale ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të kërkojë mënyrat për të planifikuar, zhvilluar, hapur dhe mirëmbajtur një ambient për të filluar përmbushjen e nevojave komplekse të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Partneriteti me organizatat e shoqërisë civile ndoshta mështë mundësia për t'a realizuar këtë prioritet. Në planet e zhvillimit duhet të ketë qëndrueshmëri. Qëndrueshmëria duhet të përfshihet në planet zhvillimore.

4. Drejtoria Arsimore Rajonale dhe Zyra e Arsimit në Bashki duhet të punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë dhe nivelin e shërbimeve arsimore të ofruara për të gjithë fëmijët, por veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin funksionimin e Komisionit të Arsimit Multi-Disiplinor për të bërë rekomandime për Planet Individuale të Arsimit, sigurimin e asistentëve të mësimdhënies si një normë (të përfshirë në buxhetin vjetor të arsimit) dhe jo si një shërbim i posaçëm për disa pajisje teknike ndihmëse dhe Sigurimi i transportit aty ku kërkohet.
5. Drejtoria e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Dibër duhet të adresojë nivelin e pagesës së Ndihmës Ekonomike dhe të planifikojë një rritje nga buxheti vendor për të plotësuar grantin e qeverisë qendrore nga viti 2018.
6. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të luajnë dhe të kenë akses në aktivitete të përshtatshme të kohës së lirë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Neni 31, kështu që Bashkia e Dibrës duhet të adresojë kërkesën për ofrimin e terreneve të lojërave të komunitetit për fëmijët.
7. Bashkia e Dibrës dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak duhet të punojnë më shumë në drejtim të hapjes, transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve të tyre, të rinj dhe të moshuar dhe t'i përfshijë ato në mënyrë aktive në planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e të gjitha shërbimeve sociale.

Rekomandime:

8. Drejtoritë dhe stafi i Bashkisë së Dibrës duhet të integrojnë praktikën e konsultimeve me shoqërinë civile dhe të dëgjojnë dhe të reflektojnë mbi njohuritë dhe përvojën e shoqërisë civile në bashki, të cilët punojnë me dhe për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe qytetarë të tjerë vulnerabël. Së bashku ata mund të përmirësojnë nivelin aktual të ulët të ofrimit të shërbimeve sociale për qytetarët në tërë bashkinë.
9. Dhënia e informacionit duhet të përmirësohet në mënyrë të tillë që qytetarët e Bashkisë së Dibrës të dinë se cilat shërbime ofrohen; kur planifikohen ose merren vendime në lidhje me shërbimet sociale, arsimore, ose shërbime të tjera që diskutohen apo vendosen nga Këshilli Bashkiak.

Shtojca 1

Intervistë gjysëm e strukturuar

Hyrje:

Faleminderit që pranuat për të marrë pjesë në këtë intervistë e cila do të na ndihmojë për të kuptuar situatën e ofrimit të shërbimeve në Bashkinë dhe mangësitë për të përmbushur nevojat e anetarëve të komunitetit.

Ky studim kryhet nga Grupi i Aktivistëve në kuadër të projektit “Advokaci Komunitare për Shërbime Sociale në Bashkinë Diber” i cili zbatohet nga Partnerë për Fëmijët dhe i cili financohet nga LevizAlbania.

Ky studim ka si qëllim hartëzimin e shërbimeve sociale që ekzistojnë në Bashkinë Diber dhe mangësitë që ekzistojnë si dhe do të ndihmojë në hartimin e një Liste me Prioritete për Shërbimet Sociale që kanë nevojë të përmiresohen apo të vendosen.

Konfidencialiteti:

I gjithë informacioni që ju do të jepni do të jetë konfidencial dhe emri juaj nuk do të lidhet me asnjë nga komentet që do të përdoren për zhvillimin e raportit final të këtij studimi.

Realizimi i Studimit:

Ne jemi përpjekur që të bëjmë pyetje të qarta dhe të përshtatshme për situatën lokale, por nëse ndonjëra nga pyetjet nuk është e përshtatshme për ju, atëherë ju lutem thuajini këtë intervistuesit. Nëse ka ndonjë pyetje që nuk doni t’i përgjigjeni, intervistuesi do të vendosë “pa përgjigje” afër pyetjes.

Ne do të kishim dëshirë që ju të jini sa më i/e sinqertë dhe i/e hapur në përgjigjet tuaja, pasi studimi ka për qëllim të mësojë rreth ofrimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Diber.

Emri & Mbiemri : _____ Moshë: _____

Qyteti/fshati: _____ Data e intervistimit: _____

Emri i intervistuesit: _____

Anëtarët e familjes (psh Kryefamiljari/e, bashkeshortja, djali, vajza, gjysh/e,	Moshë	Arsimimi	I Punësuar / I Vetëpunësuar

PJESA 1. Llojet e shërbimeve të ofruara në qytetin /fshatin tuaj.

1.1 A ka ndonjë anëtar të familjes tuaj që përfiton ndonjë nga shërbimet e mëposhtme:

Ndihmë Ekonomike	
Pagesë Papunësie	
Pagesa e Aftësisë së Kufizuar	
Pagesën e Kujdestarit për kujdes ndaj një personi/fëmije me aftësi të kufizuara	
Pension	
Tjetër, të lutem specifikoj	

1.2 Shërbimet shëndetësore:

Sherbimi shendetesor	
A ka Qendër Shëndetësore në fshat/qytet?	
A ka ndonjë mjek në dispozicion në Qendrën Shëndetësore?	
A ofrohet shërbim shtetëror dentar?	

1.3 Cilat nga llojet e shërbimeve sociale të mëposhtme ofrohen në qytetin/ fshatin tuaj

Lloje të Shërbimeve Sociale	Po	Jo	Nuk e di
Kopësht ose çerdhe për fëmijë nën moshën 7 vjeç			
Grupi i nënave të reja			
Klasat e Prindërimit			
Qendër informuese			
Qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara			
Qendër ditore për të rritur me aftësi të kufizuara			
Qendër ditore për të moshuar			
Shërbime rehabilituese për persona me aftësi të kufizuara ose të dëmtuar			
Vizita në familje nga personeli mjekësor për foshnjat dhe të sapo lindurit			
Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve			
Zyra për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje			
Shërbime ose mbështetje komunitare për shëndetin mendor			
Bibliotekë me libra për fëmijë			
Kurse Profesionale			
Këshillim			
Kënde lojërash			
Shërbim psikologjik			
Shërbim ligjor falas			
Grup rinor			
Ndihmë dhe këshillim nga Punonjësi/ja Social/e			

PJESA 2: Pjesmarrja juaj ne procesin e vendimarrjes.

2.1 Ne cfarë lloj mënyre informoheni rreth vendimeve, planeve, projekteve që zbatohen në Bashkinë Dibër:

- Përmes publikimit të informacioneve në median e shkruar dhe vizive.
- Përmes takimeve individuale me punonjës të administratës publike.
- Përmes takimeve të hapura Bashkia organizon me publikun.
- Përmes publikimit të raporteve periodike vjetore te publikuara
- Të gjitha
- Asnjëra
- Tjetër(specifiko)_____

2.2 A keni qënë ndonjëherë pjesë e takimeve në Këshillin Bashkiak? PO/JO

Nëse PO, kush ishte qëllimi i takimit?

2.3 Sa mendoni se ka qënë shkalla e pjesëmarrjes tuaj në procesin e vendimarrjes në qytetin /fshatin ku jetoni? 1 2 3 4 5

(1 - pothuaj aspak; 5 - shumë aktiv)

2.4 Si do ta përshkruani shpërndarjen e fondeve në Bashkinë/ NJQV ku jetoni në perputhje më shërbimet që nevojiten:

2.5 Cfarë lloj procedurash ka në Bashkinë/ NJQV në lidhje me sugjerimet e publikut me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimit?

2.6 Si e konsideroni marrdhënien midis anëtarëve të komunitetit dhe përfaqësuesve/drejtuesve të Bashkisë Dibër ?

2.7 Cfarë shërbimesh do të doni që të ofroheshin në komunitetin tuaj për fëmijën tuaj me aftësi të kufizuara në komunitetin ku ju jetoni?

Faleminderit për kohën dhe pjesmarrjen në këtë studim!

Referencat

- EPI Briefing Paper: Economic Policy Institute; October 2008.
www.epi.org
- **Good Practice Participate** Working with Specific Groups: Internal Affairs – Te Tari Taiwhenua
- <http://ifsw.org/policies/definition-of-social-work/>
- National Strategy on Persons with a Disability
- UN Convention on the Rights of the Child 1989
- <http://umbrellanetwork.org/wp-content/uploads/2011/04/Endevour-Advocate-Booklet.pdf>
- <http://www.fcssaa.org/sites/default/files/documents/Module%20%20Advocacy.pdf>
- <http://www.scie.org.uk/care-act-2014/advocacy-services/commissioning-independent-advocacy/inclusion-empowerment-human-rights/types.asp>